

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AlDent Store” SH.P.K

Sot në datë 09.12.2024, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë ortaket :

- **Z. Saimir Cili**, i biri i Tomorr dhe Hysmete Cili, i datëlindjes 06.07.1993, i lindur në Gjonme, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: J30706026K.
- **Z.Guxim Cili**, i biri i Tomorr dhe Hysmete Cili, i datëlindjes 03.07.1989, i lindur në Gjonme, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I90703015I.
- **Z.Sokol Meta**, biri i Osman dhe Beglje Meta, i datëlindjes 26.07.1987, i lindur në Burrel, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I70726081A.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themeli dhe Statuti.

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “AlDent Store” SH.P. K

Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë është në adresën : Rr. Barrikadave , Njesia Bashkiake nr.9, Banesa tek ish Kinema 17 Nëntori, (Galeria) Tiranë, Shqipëri, me nr. Pasurie 7/406-N30, zone kadastrale 8360, Volumi 16, Fq.140, Tiranë.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:



- Import - eksport, ruajtje, tregtimin me shumice dhe pakice, shperndarje, promovim, reklamim i Pajisje Mjeksore, produkteve parafarmaceutike, shtesa ushqimore, produkte bimore, pajisje dentare, kozmetike, produkte te ndryshme te kujdesit shendetesor. Marrje me qira e hapesirave per reklamim, organizim konferencash, trajnimesh ne fushen mjekesore dhe farmaceutike, kurse te formimit professional per pajisjet mjekesore dhe kozmetike. Perfaqesimin e kompanive shqiptare dhe te huaja qe kane objekt te njejtë apo te perafert me ate te shoqerise. Kryerja e cdo aktiviteti tjeter mbeshtetes sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi per te kryer aktivitetet e mesiperme. Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria do te bashkepunoje e lidhe marreveshje me cdo person fizik apo juridik, vendas ose te huaj. Shoqeria mund te kryej cdo operacion financiar, tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme, qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me nje nga objektet e saj. Qiradhenie e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Blerje reklamash ne median e ndryshme elektronike dhe te shkruar.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaket e shoqërisë: **Z.Sokol Meta**, perkatesisht 30% (tridhjte) perqind ne vleren 30.000 (tridhjete mijë) leke te kapitalit te shoqerise , **Z.Guxim Cili** perkatesisht 45% (dyzet e pese) perqind ne vleren 45.000 (dyzet e pese mijë) leke kapitalit te shoqerise dhe **Z. Saimir Cili** perkatesisht 25% (njezet e pese) perqind ne vleren 25.000 (njezet e pese mijë) leke te kapitali te shoqerise. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 kuota, me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakeve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim;

Neni 7- Administratorët

Me këtë Akt emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Sokol Meta**, biri i Osman dhe Beglje Meta, i datëlindjes 26.07.1987, i lindur në Burrel, Shqipëri, dhe banues në Tiranë, Rr. Artan Lenja, Pll 11, Ap.22, Kati 4, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: 170726081A.

Neni 8 – Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është i përbërë në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.


ORTAKET E SHOQËRISË

“AlDent Store” SH.P. K

Z. Sokol Meta

Sokol Meta 

Z. Guxim Cili

Guxim Cili 

Z. Saimir Cili

Saimir Cili 